



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1148/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Skender Vitise anetare i AKR-se dega ne Prishtine, konkretisht kandidat per asamble komunale te Prishtines paraqitur kunder Komisionit Qendror te Zgjedhjeve (KQZ) pas publikimit te rezultateve perfundimtare per kuvend komunal për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor dhe Manipulimit te votave , në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Skender Vitise kandidat per kuvendin komunal te Prishtines nga rradhet e AKR-se dega ne Prishtine.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Skender Vitia anetare e subjektit politik te AKR-se, konkretisht kandidate per asamble komunale te Komunes se Prishtines në të cilën pretendon se ne vendvotimin ku ka votuar i lartepemenduri nuk e ka voten, si edhe ne vendvotimet ku i kan humbur votat jane shkollat Gjin Gazulli, Gjergj Fishta , Zenel Hajdini, Emin Duraku, Elena Gjika, Mitrush Kuteli.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjate procesit zgjedhor , vlersohen si te pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1148/2013 më datën 06.12.2013



Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*